



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 50 datë 02.06.2025



**“PËR MIRATIMIN E PLANIT AFATMESËM TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË
BASHKINË PËRMET 2025-2028”**

Këshilli Bashkiak Përmet në mbledhjen e tij të datës 02.06.2025, në bazë të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, neni 23 pika 12, neni 54 pika k, Ligjin nr. 69/2018 “Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë, dhe me propozim nga Kryetari i Bashkisë Përmet,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Planin Afatmesëm të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë Përmet” sipas dokumentit bashkëlidhur si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë; Drejtoria e Përfshirjes Sociale, Arsimit, Kulturës, Sportit; Drejtoria e Financë Buxhetit, Burimeve Njerëzore dhe Zyra Juridike sipas structures organizative dhe përgjegjësisë së tyre.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI

PLANI AFATMESEM PËR
ARSIMIN PARAUNIVERSITAR
BASHKIA PËRMET



2025-2028

Përmbajtja:

- I. PROCEDURA E HARTIMIT TË PLANIT, BAZA LIGJORE**
- II. KREDO**
- III. POLITIKA DHE STRATEGJIA E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**
- IV. ANALIZA E GJENDJES**
 - A. Arsimi Parashkollor
 - B. Arsimi 9-vjeçar AMU
 - C. Arsimi i Mesëm i Lartë
 - D. Mësues dhe Edukatore
 - E. Infrastruktura
- V. PRIORITETET**
- VI. OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË PËR ARRITJEN E PRIORITETEVE**
- VII. BUXHETI I PËRAFËRT**



I. PROÇEDURA E HARTIMIT TË PLANIT AFATMESËM

- a. Plan – draft nga grupi qendror i punës të ngritur me Urdhër të Kryetarit Nr. 49 datë 12.02.2025.
- b. Organizimi i diskutimit të draftit në:
 - Dëgjesa Publike me grupet e interesit, organizuar takime dhe mbajtur ProcesVerbale nga Grupi i Punës më datat : 20 Shkurt 2025; 3 Mars 2025; 10 Mars 2025 dhe 17 Mars 2025.
 - Mbledhja e sugjerimeve dhe rekomandimeve nëpërmjet pyetësorëve fizik në 200 individë pjesë e grupeve të interesit si nxënës, prindër, mësues dhe komunitet.
 - Komisioni i Arsimit në Këshillin Bashkiak organizuar takimi datë 15 Maj 2025.
- c. Miratimi i planit nga Kryetari i Bashkisë.
- d. Miratimi në Këshillin Bashkiak me Vendim Nr.50 datë 02.06.2025.
- e. Publikimi në faqen zyrtare të Bashkisë në menunë Konsultimi Publik 2025 dhe menuja Plane Strategjike si dhe në platformën Vendime.al
- f. Zbatimi i planit fillon Shtator 2025.

1- Grupi qendror i punës:

- | | |
|-----------------------|--|
| • Aulona Meshini | N/kryetar i Bashkisë |
| • Arjana Papapano | Drejtor i Mbështetjes Sociale, arsim, kulturë, sport |
| • Margarita Tetollari | Drejtor i arsimit parashkollor |
| • Julinda Karafili | Specialiste juridike në ZVA Përmet-Këlcyrë |
| • Manjola Mehmeti | Edukatore |
| • Eliona Jaçe | Koordinatorë e sigurimit të cilësisë në shkollë |
| • Valmira Duro | Prind/Psikologe |
| • Behije Murataj | Prind/Kryetar i Këshillit të prindërve |
| • Miranda Habili | Drejtor i shkollës 9- vjeçare “M. Gosnishti” |



2- Grupet e punës për:

➤ Vizionin dhe përparësitë.

- Aulona Meshini N/kryetar i Bashkisë
- Arjana Papapano Drejtor i Mbështetjes Sociale, arsim ,kulturë,sport
- Margarita Tetollari Drejtor i arsimit parashkollor
- Ledjon Komino Specialist i arsim,kulturë
- Valmira Duro Prind
- Anida Hajredini Drejtor i shkollës 9-vjeçare “N. Bulka”
- Kostandin Meshini Drejtor i shkollës së mesme “Sami Frashëri”

➤ Analizën e gjendjes dhe buxhetin e përafërt

- Etleve Kreci Drejtor financë, burime njerëzore
- Klaudja Ciko Drejtor i projekteve dhe integritetit evropian
- Arjana Papapano Drejtor i Mbështetjes sociale, arsim, kulture, sport

➤ Vëzhgim dhe monitorim të zbatimit të planit afatmesëm:

- Arjana Papapano Drejtor i Mbështetjes Sociale,arsim,kulturë,sport
- Ledjon Komino Specialist arsim,kulturë
- Margarita Tetollari Drejtor i arsimit parashkollor
- Mirela Streio Edukator



- Klaudja Ciko Prind
- Eliona Jaçe Koordinator e sigurimit të cilësisë në shkollë

Arsimi Parauniversitar (planifikimi dhe regjistrimi)

Baza ligjore

- **Ligji Nr. 139/2015** "Për Vetëqeverisjen Vendore"
- **Ligji Nr. 69/2012** "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2018
- **VKM Nr.662, date 8.10.2014**-“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve parauniversitare publike”
- **Ligji Nr.9645, date 20.11.2006**”Për Prokurimet Publike”, i ndryshuar
- **VKM Nr.159 datë 1.3.2017**-“Për miratimin e standarteve të projektimit të kopshteve”
- **Ligji Nr.9936, date 20.06.2008**,”Për Menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 6,15,32,33,47.
- **Ligji Nr.68, date 27.04.2017**”Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”nenet 12,14,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43,44,45,46,50,51,53,54.
- **Ligji Nr.9632,date 30.10.2006**”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar
- **Ligji Nr. 121/2016** "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"
- **Ligji Nr. 18/2017** "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"
- **Urdhër Nr. 31, datë 28.01.2020** "Për miratimin e Rregullores për Funksonimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë"; Kreu III, "Arsimi Bazë"
- **Udhëzimi i përbashkët MAS-MEKI Nr. 13, datë 10.07.2024** "Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar"



- **Udhëzimi Nr. 14, datë 10.07.2023** "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar"
- **Udhëzimi Nr. 21, datë 08.08.2014** "Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë"
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025)**

3. Bashkia Përmet të dhënat demografike dhe historiku i shkollave dhe kopshteve

Bashkia Përmet bën pjesë në Qarkun e Gjirokastrës dhe shtrihet në pjesën juglindore të vendit. Ajo kufizohet në veri me Skraparin, në lindje me Bashkinë Kolonjë, në perëndim me Bashkinë Libohovë dhe Këlcyrë dhe në jug me Konicën, Greqi. Qendra e Bashkisë është qyteti i Përmetit, i cili përfaqëson qendrën e zhvillimit ekonomik dhe social jo vetëm për Bashkinë e Përmetit por të gjithë komunitetit gjeografik që njihet si Lugina e Vjosës.

Bashkia e Përmetit përbëhet nga 5 (pesë) njësi administrative të cilat janë: Përmet, Çarshovë, Frashër, Petran dhe Qendër Piskovë. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 49 fshatra. Të gjitha njësitë e bashkisë janë njësi malore duke qenë se terreni është i pjerrët në më shumë se 45% të sipërfaqes së tij.

Tabela 1 - Përbërja administrative e territoriale e bashkisë Përmet.

Bashkia	Njesitë administrative	Qytetet dhe fshatrat respektive
Përmet	Përmet	Qyteti Përmet
	Çarshovë	Fshatrat; Çarshovë, Vllaho, Psillotere, Biovizhde, Zhepë, Draçovë, Iliar, Munushtir, Strëmbec, Pëllumbar, Kanikol
	Frashër	Fshatrat; Frashër, Zavalan, Ogren, Kostrec, Gostivisht, Miçan, Verçisht, Kreshovë, Soropull
	Petran	Fshatrat; Petran, Leshnicë, Leus, Lipe, Qilarishtë, Badilonjë, Bënje, Novosele, Delvinë, Kaludh, Lupckë, Gjinakar, Ogdunan, Lipivan-Trabozishtë, Tremisht, Bodar
	Qendër Piskovë	Fshatrat; Piskove, Bual, Kosine, Rapcke, Mokricë-Zleushë, Kutal, Kosovë, Hotovë, Odriçan, Raban, Alipostivan, Borockë, Gosnisht, Pagri, Pacomit, Grabovë, Argovë



Territori i Bashkisë është i organizuar përgjatë luginës së lumit Vjosa. Njësitë e Çarshovës, Petranit, Përmetit dhe një pjesë e Qendër Piskovë shtrihen përgjatë luginës, ndërsa, njësia administrative e Frashërit përbën skajin më të largët të bashkisë dhe është terësisht një zonë malore. Jetesa përgjatë luginës përcakton edhe një standart më të mirë jetese për komunitetet lokale krahasuar me ato që jetojnë më larg luginës.



2.1 Popullsia dhe treguesit demografikë

Përmeti bën pjesë në rajonin statistikor NUTS 3– Qarku Gjirokastrë. Tabela më poshtë jep informacion në lidhje me sipërfaqen, ndarjen administrative, dhe numrin e popullsisë.

Tabela 2 - Të dhëna mbi sipërfaqen, ndarjen administrative dhe numrin e popullsisë

Sipërfaqe (km ²)	Numri i Njësive Administrative	Numri i Qyteteve	Numri i Fshatrave	Numri i Familjeve	Popullsia sipas Regjistrat Civil 2016	Popullsia sipas Census 2011
601.95	5	1	49	6,868	19,872	10,614

Burimi: Bashkia Përmet



Siç u përmend më lart, një pjesë e rëndësishme e territorit të bashkisë shtrihet në terren malor. Një reliev i tillë kushtëzon dendësinë relativisht të ulët të popullsisë për zonat më të largëta.

Popullsia e Bashkisë sipas Regjistrat Civil 2023 raportohet 19.872 banorë. Më shumë se gjysma e popullsisë, rreth 56%, jeton në qytetin e Përmetit. Njësia administrative me numrin më të vogël të popullsisë është Frashëri. Njësitë e tjera (Çarshovë, Petran dhe Qendër Piskovë) përbëjnë 40% të popullsisë së bashkisë. Bashkia e Përmetit ka fshatra që kanë një numër shumë të ulët banorësh, siç është fshati Frashër i cili ka 683 banorë. Kjo analizë demografike na shërben për të orjentuar disa shërbime të kujdesit social të cilat diktohen nga situata të veçanta demografike siç janë shërbimet sociale dhe shëndetsore për të moshuarit e vetmuar në zona shumë larg qytetit ose malore.

Tabela 3 - Të dhëna për numrin e popullsisë sipas njësive administrative

Njësitë administrative	Censusi 2011			Regjistri civil 2023		
	Femra	Meshkuj	Total	Femra	Meshkuj	Total
Përmet	2.984	2.961	5945	5.028	4.832	9.860
Çarshovë	463	455	918	1.425	1.544	2.969
Petran	791	831	1622	1.550	1.540	3.090
Qëndër Piskovë	845	897	1742	1.602	1.668	3.270

Frashër	177	210	387	314	369	683
Total	5.260	4.904	10.614	9.919	9.953	19.872

Burimi: Bashkia Përmet

Në tabelën e mësipërme, shihet se raporti gjinor i popullsisë në Bashkinë Përmet është i balancuar. Gratë përfaqësojnë 50% të popullsisë totale.

Popullsia e grupmoshës 15-64 vjeç që përfaqëson popullsinë aktive, përbën 66% të popullsisë. Ajo që vihet re në piramidën e moshës për Bashkinë Përmet është se grupmosha 65+ vjeç, përfaqëson 18% të popullsisë, tregues ky që është më i lartë se mesatarja e vendit (11.3%). Nga ana tjetër grupmosha 0-14 vjeç përbën 16% të popullsisë së Bashkisë Përmet, tregues i ulët në krahasim me mesataren e vendit (20.7%).

Tabela 4 - Popullsia, raporti sipas grupmoshave

Popullsia sipas grupmoshave	Bashkia Përmet	Mesatarja e vendit
	%	%
0-14	16%	20.7%
15-64	66%	68%
65- e lart	18%	11.3%

Burimi: Bashkia Përmet



I gjithë territori i Bashkisë është karakterizuar nga migrimi dhe emigrimi i popullatës në dy dekadat e fundit. Të dhënat e Census 2001 dhe 2011, tregojnë se popullsia e Bashkisë Përmetit është zvogëluar me më shumë se gjysmën e popullsisë (56%). Njësia administrative Frashër në harkun kohor 2001-2011, ka patur një largim masiv të banorëve në masën 82%. Po kështu, edhe popullsia e njësive administrative Çarshovë është ulur me 71%. Përmeti (qyteti) ka përqindjen më të vogël të popullsisë së larguar (51%), krahasuar me njësitë e tjera administrative.

Të dhënat tregojnë për një rënie të konsiderueshme të popullsisë për të gjitha njësitë administrative, e cila ka si shkak kryesor migrimin e brendshëm (largimin e banorëve drejt qytetit të Përmetit dhe qyteteve të tjera) dhe emigrimin (kryesisht në Greqi). Por ulja e popullsisë është shkaktuar edhe për shkaqe të tjera. Kështu, treguesit e lindshmërisë dhe vdekshmërisë të cilët përbëjnë variablat bazë për vlerësimin e shtesës natyrore të popullsisë tregojnë se ky tregues i shprehur si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve është negativ. Tabela më poshtë paraqet

numrin e lindjeve, vdekjeve, martesave, dhe divorceve në periudhat 2017-2018 dhe 2021-2023. Numri i lindjeve është shumë i ulët. Në vitin 2022 për shembull janë regjistruar vetëm 17 lindje dhe deri në gjysmën e vitit 2023, numri i lindjeve në Përmet ishte 5.

Tabela 5 - Numri i lindjeve dhe vdekjeve për dy vitet e fundit në Bashkinë Përmet

	2017	2018	2021	2022	2023	2024
Lindje	39	49	14	17	5	14
Vdekje	117	112	180	145	48	104
Martesa	15	27	42	35	21	28
Divorce	5	7	12	22	3	8

Burimi: Bashkia Përmet, Zyra e Gjendjes Civile

**Shënim: Të dhënat e vitit 2024 janë të dhënat e fundit.*



Shtesa natyrore negative, migrimi dhe emigrimi kryesisht i popullatës aktive, kanë qenë faktorë të rëndësishëm të cilët kanë përcaktuar edhe tendencën e plakjes së popullsisë me ritme të shpejta. Procesi i plakjes vihet re nga rritja e lehtë e popullsisë mbi 65 vjeç, shoqëruar kjo me uljen e numrit të popullsisë në moshë të re 0-14 vjeç.

Historiku i shkollave dhe kopshteve

-Historiku i shkollë së mesme “S. Frashëri”. Gjimnazi i hapi dyert në vitin 1957, fillimisht në godinën që sot është shkolla 9- vjeçare “N. Bulka” dhe në vitin 1969 në godinën aktuale, në një vend panoramik pranë gurit të qytetit (monument natyre). Deri në vitin 1989, paralel me shkollën e ditës funksiononte edhe shkolla pa shkëputje nga puna. Shkolla me profesionalizëm dhe ekipin mësimdhënës në vite ,është përfaqësuar cilësisht në rang kombëtar nëpërmjet rezultateve cilësore dhe reflektimit të kulturës, qytetarisë me jetën kulturore dhe sportive. Nga dyert e kësaj shkolle kanë dalë 6 nxënës me Medalje të Artë. Në vite mësuesit janë vlerësuar me titull “Mësues i Merituar”. Nga kjo shkollë kanë dalë edhe Akademiku Kristo Frashëri dhe Doktore e Shkencave Hëna Pasho

-Shkolla 9- vjeçare “M. Gosnishti” hapi dyert e saj më 1 shtator 1963 me 354 nxënës. Në varësi të saj kanë qenë shkollat e fshatrave; Leus, Qilarisht, Lëshicë, Lipë. Gjatë gjithë kësaj periudhe kanë mbaruar arsimin tetë e nëntëvjeçar rreth 5700 nxënës. Pas rikonstruksionit të godinës dhe ambienteve rreth saj shkolla u kthye me standarte bashkëkohore.

-Shkolla 9- vjeçare “N. Bulka” hapi dyert e saj në vitin 1909 në lagjen “Partizani”. U krijua si shkolla e vetme në qytet për 60 vite, në të cilën zhvillonte mësimin edhe shkolla e mesme. Shkolla u rikonstruktua në vitin 2005 si një godinë dykatëshe me sistem ngrohje, mjedise sportive.

-Shkollat e qytetit funksionojnë si shkolla Qëndër Komunitare.

-Shkolla “1 Maji” Piskovë dhe shkollat vartëse.

-Shkolla 9- vjeçare publike “1 Maji” hapi dyert e saj në vitin 1964 në fillim u krijua shkolla e mesme e bashkuar me profil (agronomi) ku do të mësonin fëmijët e këtij fshati dhe fshatrave rreth tij. Shkolla u rikonstruktua në vitin 2008 një godinë trekatëshe. Sot funksionon si shkollë 9- vjeçare.

Shkolla “S. Zhaka” Kosinë i ka hapur dyert në vitin 1972. Sot kjo shkollë numëron 16 nxënës dhe japin mësim dy mësues.

Shkolla në Rapckë e Pacomit u hapën në vitin 1973. Sot kanë nga një klasë kolektive.

-Shkolla Iljar i hapi dyert e saj në vitin 1978. Në vitin 2024 kishte 42 nxënës dhe 10 mësues.

-Shkolla Kaludh i hapi dyert në vitin 2009. Shkolla e Çarshovës i hapi dyert në vitin 1984 si shkollë 8- vjeçare dhe e mesme sot kjo shkollë nuk funksionon më, në këto shkolla mungojnë kushtet bashkëkohore për zhvillimin e mësimi.

Godinat aktuale të kopshtit dhe çerdhes janë ndërtuar rreth viteve 70-80 me një kapacitet të plotë, pas viteve 90 kopshti me drekë u mbyll dhe u rihap në vitin 2019. Tre godina janë më vete kurse katër të tjera ndodhen brenda godinave të shkollave.

Burimi: bashkia Përmet, ZVA Përmet-Këlcyrë



II. KREDO:

II.1 Misioni

II.2 Besimi

II.3 Vizioni

II.1 Misioni

Pushteti vendor angazhohet të ndërtojë një sistem arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe inovativ, që garanton mundësi të barabarta për çdo fëmijë dhe të ri. Përmes investimeve në infrastrukturë, rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe fuqizimit të partneriteteve, synojmë të krijojmë një mjedis të sigurt, ku nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre akademike, profesionale dhe sociale, duke u përgatitur për të ardhmen me kompetenca të përshtatshme për tregun e punës dhe shoqërinë.

II.2 Besimi

Arsimi është themeli i zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë dhe një e drejtë e patjetërsueshme për çdo fëmijë dhe të ri.

Besimi ynë:

Bazohet në parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes dhe cilësisë, duke siguruar që çdo nxënës të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për t'u zhvilluar dhe për të arritur potencialin e tij maksimal.

Ne besojmë te:

Fuqia e edukimit për të krijuar qytetarë të ndërgjegjshëm, të aftë dhe të përgjegjshëm, të gatshëm për të përballuar sfidat e së ardhmes.

Ne besojmë se mësuesit:

Perpiqen të japin një edukim për nxënësit dhe fëmijët i cili, bazohet dhe ka një përfundim për nxënësit bazuar në nivele të studimi dhe në cikle shkollore.

Janë lehtësues dhe e drejtojnë procesin mësimor të të nxënit me në qendër nxënësin.

Përpiqen ta zhvillojnë kurrikulën në një mënyrë motivuese për të gjithë nxënësit.

Janë të përgjegjshëm për rezultatet e të nxënit që hartojnë për tema dhe orë mësimore.



Janë përgjegjës për arritjet e nxënësve

Ne besojmë që prindërit:

Janë bashkëpunues dhe mbështetës të vazhdueshëm të mësuesve dhe edukatorëve.

Luajnë një rol të rëndësishëm gjatë procesit të edukimit dhe shkollimit.

Janë përgjegjës kryesorë për mbarëvajtjen e fëmijëve të tyre brenda dhe jashtë procesit mesimor.

Duhet të përfshihen në mënyrë të përgjegjshme në vendimmarrje .

Janë të hapur për një komunikim të rregullt me shkollën.



II.3 Vizioni:

TË NDËRTOJMË NJË SISTEM ARSIMOR GJITHPËRFSHIRËS, CILËSOR DHE INOVATIV, QË GARANTON ZHVILLIMIN E PLOTË TË FËMIJËVE DHE TË RINJËVE, DUKE KRIJUAR NJË MJEDIS TË SIGURT, TË MOTIVUESHËM DHE ME MUNDËSI TË BARABARTA PËR TË GJITHË.

-Zhvillimi i arsimit parashkollor.

a)Zgjerimi i qasjes dhe mbulimit: Rritja e numrit të kopshteve publike dhe përmirësimin e infrastrukturës së tyre për të garantuar akses në arsimin parashkollor për të gjithë fëmijët.

b)Cilësia e edukimit:Formimi i vazhdueshëm i edukatorëve për të zbatuar metoda bashkëkohore të mësimdhënies dhe për të promovuar zhvillimin social,emocional dhe intelektual të fëmijëve.

c)Mbështetje për familjet:Hartimi i politikave për të ndihmuar familjet me të ardhura të ulëta në përfshirjen e fëmijëve të tyre në arsimin parashkollor.

-Përmirësimi i arsimit 9-vjeçar.

a)Modernizimi i infrastrukturës:Investime në rikonstruksionin dhe pajisjen e shkollave me laboratorë,klasa digjitale dhe hapësira të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore.

b)Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies:Trajnimi për mësuesit mbi teknologjinë në arsim,metodat interaktive dhe mësimin e personalizuar.

c)Mbështetje për nxënësit me nevoja të veçanta:Zhvillimi i programeve të integritit dhe sigurimi i mbështetjes psikologjike dhe logopedike për fëmijët me vështirësi në të nxënë.

d)Reduktimi i braktisjes shkollore:Hartimi i strategjive për identifikimin e hershëm të nxënësve në rrezik dhe ofrimi i mbështetjes financiare dhe psikologjike për ta.

-Rritja e cilësisë në arsimin e mesëm të lartë.

a)Zgjerimi i alternativave të arsimit të mesëm:Përmirësimi i shkollave dhe bashkëpunimi me bizneset për praktika dhe mundësi punësimi pas përfundimit të shkollës.Përshtatja e kurrikulave me tregun e punës.Rritja e përfshirjes së aftësive praktike,teknologjike dhe sipërmarrëse në mësimdhënie.Mbështetje për nxënësit me performancë të lartë.Krijimi i programeve të avancuara për nxënësit e talentuar në shkencë,teknologji,art dhe inovacion.

b)Forcimi i orientimit profesional:Ofrimi i këshillimit për karrierën dhe mbështetja për përzgjedhjen e studimeve të mëtejshme apo punësime.

Mekanizmat e zbatimit :

- Buxhetim i dedikuar për investime në arsim.
- Partneritet me sektorin privat dhe organizatat jofitimprurëse.
- Digjitalizimi dhe inovacioni në procesin mësimor.
- Fuqizimi i rolit të pushtetit vendor në mbikëqyrjen dhe mbështetjen e shkollave..
- Krijimi i mekanizmave të matjes së performancës dhe transparencës.



III. POLITIKA DHE STRATEGJIA E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

-Politikat dhe strategjitë për arsimin parauniversitar janë të ndara midis pushtetit qendror (ministritë e linjës) dhe pushtetit lokal (bashki dhe njësi administrative).Politikat dhe strategjitë e arsimit parauniversitar përqëndrohen në unifikimin e kurrikulave për fëmijët nga 3 deri 18 vjeç, duke lehtësuar kalimin nga parashkollori në klasë e parë dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve.

-Një aspekt tjetër është përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet trajnimeve për mësuesit dhe edukatorët si dhe reformat në sistemin e arsimor.

-**Menazhimi** i institucioneve arsimore është nën përgjegjësinë e pushtetit vendor, i cili siguron infrastrukturën, mirëmbajtjen dhe financimin e tyre.-**Zbatimi i politikave të decentralizimit.** Bashkitë kanë detyrën të zbatojnë politikat e qeverisë qendrore për arsimin parashkollor, duke siguruar një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës për fëmijët.

-**Bashkëpunimi** me Ministrinë e Arsimit për standartet arsimore. Pushteti vendor punon me Ministrinë e Arsimit për të garantuar kurrikulën dhe standartet kombëtare të Arsimit Parauniversitar.

– **Investime në infrastrukturë:** Përmirësimi i Kushteve të institucioneve të arsimit parauniversitar është një prioritet i bashkive , shpesh në bashkëpunim me organizata nderkombëtare dhe donator.

– **Përafrimi me tregun e punës,** duke integruar element të arsimit në praktika profesionale. – Rritja e autonomies së shkollës, forcimi i transparencës dhe llogaridhënies në sistemin arsimor.

IV. ANALIZA E GJENDJES

A. Të dhëna për arsimin parashkollor

Nr	Treguesit	Të dhëna
1	-Numri i fëmijëve në arsimin parashkollor për vitin 2024 gjithësej	139 / f (70)
2	-Numri i fëmijëve në qytet	112/ f (57)
3	-Numri i fëmijëve në Njësitë Administrative	27/ f (13)



4	-Numri i fëmijëve në kopshtin me drekë	68/ f (41)
5	-Numri i fëmijëve në kopshtin pa drekë	44/ f (17)
6	-Numri i grupeve në kopshtin me drekë 3(gupe)	1(një) grup i parë, 2(dy)gr të përzier
7	-Numri i grupeve në kopshtin padrake 4(grupe)	1(një) i(parë), 2(dy) gr të (dyta),1(një) i (tretë)
8	-Grupet në Njësitë Administrative 5(grupe)	Nga 1(një) të përzier
9	-Anët e forta	Nuk kemi asnjë fëmijë të pa regjistruar.Prindrit janë të interesuara për edukimin e fëmijëve në institucionet e arsimit parashkollor.
10	-Anët e dobëta	Kemi akoma grupe të përziara dhe sidomos në Njësitë Administrative.

Burimi:Bashkia Përmet



• Aspekti social i arsimit parashkollor

Nr	Treguesit	Të dhëna
1	-Numri i fëmijëve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike	5 fëmijë
2	-Numri i fëmijëve pa njërin prind	1 fëmijë
3	-Numri i fëmijëve që nuk janë në kujdestarinë e prindërve	0
4	-Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara	0

5	-Numri i fëmijëve të komunitetit romë/egjiptianë	2 fëmijë
6	-Numri i fëmijë që vinë nga familje me prindër të divorcuar	3 fëmijë f(1)
7	-Anët e forta	-Nga kopshti është treguar një kujdes i veçantë për fëmijë me një prind e sidomos për ata me ndihmë ekonomike.
8	-Anët e dobëta	- Duhet një bashkëpunim më i mirë midis edukatoreve dhe prindërve, për fëmijët me aftësi ndryshe dhe familjet me ndihmë ekonomike me qëllim zbutjen e problemeve sociale. -Duhet të ketë psikolog në arsimin parashkollor.

Burimi :Bashkia Përmet

<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Udher-Nr.-31-date-28.01.2020-Rregullore-per-IAP.pdf>

❖ Të dhëna për Arsimin Parashkollor (vitim 2024-2025)

Numri i fëmijëve në kopshtin me drekë në qytet viti 2024-2025

Grupi i fëmijëve kopshti me drekë	Grup i përzier I	Grup i përzier II	Grup i përzier III
Nr. i fëmijëve	26	26	16
Nr. i femrave	20	16	5



Numri i fëmijëve në kopshtin pa drekë në qytet viti 2024-2025

Grupi i fëmijëve kopshti pa drekë	Grupi i I	Grupi i II	Grupi i III
Nr.i fëmijëve	10	11	23
Nr. i femrave	3	4	10

Numri i fëmijëve në kopshtet e Njesisë Administrative Piskovë viti 2024-2025

Grupi i fëmijëve	Grup i përzier Piskovë	Grup i përzier Pacomit	Grup i përzier Kosinë
Nr. i fëmijëve	4	3	5
Nr. i femrave	2	2	1



Numri i fëmijëve në kopsht Njësia Administrative Petran fshati Petran viti 2024-2025

Grupi i fëmijëve	Grup i përzier
Nr.i fëmijëve	8
Nr.i femrave	3

Numri i fëmijëve në kopsht Njësia Administrative Çarshovë fshati Kaludh viti 2024-2025

Grupi i fëmijëve	Grupi i përzier
Nr. i fëmijëve	7
Nr. i femrave	5

Burimi :Bashkia Përmet



B. Të dhënat për arsimin 9-vjeçar (Arsimi i Mesëm i Ulët) viti 2024-2025

Nr	Treguesit	Të dhëna
1	-Numri i nxënësve në shkollën “N. Bulka”	205 nx f(106)
2	-Numri i nxënësve në shkollën “M. Gosnishti”	218 nx f(102)
3	-Numri i nxënësve në shkollën “1 Maji” së bashku me shkollat vartëse.	75 nx f(34)
4	-Anët e forta	-Stafi pedagogjik tregon një kujdes të veçantë për nxënësit që shkolla të jetë e dashur për ta. -Pushteti vendor përpiqet vazhdimisht të krijojë kushte dhe ambiente sa më të mira.
5	-Anët e dobëta	-Ulja nga viti në vit i nr. të nxënësve. Kjo vjen si rezultat i emigracionit në vend dhe migrimit të brendshëm të popullsisë. -Ulja e shtimit natyrorë të popullsisë.



Aspekti social i arsimit 9- vjeçar (arsimi i mesëm i ulët)

Nr	Treguesit	Të dhëna
1	-Numri i fëmijëve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike	24 nxënës f(12)
2	-Numri i fëmijëve pa njërin prind	12 nxënës f (9)
3	-Numri i fëmijëve që nuk janë në kujdestarinë e prindërve	4 nxënës f (3)
4	-Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara	15 nxënës f (3)
5	-Numri i fëmijëve të komunitetit romë/egjiptianë	19 nxënës f (12)
6	-Numri i fëmijëve që vijnë nga familje me prindër të divorcuar	28 nxënës f (3)
7	-Anët e forta	-Është treguar një kujdes i veçantë për nxënësit me 1(një) prind dhe ata që trajtohen me ndihmë ekonomike
8	-Anët e dobëta:	-Duhet një bashkëpunim më i madh midis shkollës dhe prindërve për nxënësit me aftësi ndryshe si dhe familjet me ndihmë ekonomike, për të zbutur problemet sociale.

Burimi:ZVA Përmet-Këlcyrë



❖ Të dhëna për Arsimin e Mesëm të Ulët (viti shkollor 2024-2025)

1.Numri i nxënësve sipas klasave në shkollë 9- vjeçare “N.Bulka” viti 2024 - 2025

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Nr. i nxënësve	20	15	19	16	17	33	30	18	17
Nr. i femrave	13	4	13	8	13	20	18	9	8

Shkolla 9- vjeçare Petran viti 2024-2025

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Nr. i nx	0	1	5	2	3	2	0	0	2
Nr. i femrave	0	0	2	0	2	2	0	0	2

Shkolla 9- vjeçare Gjinkar viti 2024-2025

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Nr. i nxënësve	0	0	0	1	1	0	0	0	0
Nr. i femrave	0	0	0	1	0	0	0	0	0

Shkolla 9- vjeçare Kutal viti 2024-2025

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Nr. i nxënësve	0	0	1	0	0	0	0	0	0
Nr. i femrave	0	0	1	0	0	0	0	0	0

Shkolla 9- vjeçare Buhal viti 2024-2025

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
-------	---	----	-----	----	---	----	-----	------	----



Nr. i nxënësve	0	1	0	0	1	0	0	0	0
Nr. i femrave	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Numri i klasave paralele për shkollën 9-vjeçare “N.Bulka” dhe shkollat vartëse viti shkollor 2024-2025

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Numri i paraleleve	1	3	3	3	4	3	3	1	1

❖ Të dhëna për Arsimin e Mesëm të Ulët (viti shkollor 2024-20245)

1.Numri i nxënësve sipas klasave në shkollë 9- vjeçare “M. Gosnishti” viti 2024 - 2025

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Nr. i nxënësve	15	21	31	19	19	20	31	36	26
Nr. i femrave	9	9	13	10	7	10	16	17	11



2.Numri i klasave paralele për shkollën “M. Gosnishti” për vitin shkollor 2024-2025

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Numri i paraleleve	1	1	2	1	1	1	2	2	1

3-Numri i nxënësve sipas klasave në shkollën 9- vjeçare “1- Maj” Piskovë dhe shkollat vartëse

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Nr. i nxënësve	3	1	3	3	0	7	0	5	7
Nr. I femrave	0	0	1	1	0	2	0	0	5

Numri i nxënësve në shkollën fillore Pacomit viti 2024-2025

Klasa	I	II	III	IV	V
Nr. i nxënësve	0	0	0	2	0
Nr. i femrave	0	0	0	1	0



Numri i nxënësve në shkollën fillore Rapckë viti 2024-2025

Klasa	I	II	III	IV	V
Nr. i nxënësve	0	0	0	1	0
Nr. i femrave	0	0	0	1	0

Numri i nxënësve në shkollën 9- vjeçare Kosinë viti 2024-2025

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Nr. i nxënësve	0	0	2	0	1	1	3	1	1
Nr. i femrave	0	0	2	0	0	0	2	0	0

Numri i nxënësve në shkollë 9- vjeçare Iljarë viti 2024-2025

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Nr. i nxënësve	1	1	0	1	1	1	8	7	6
Nr. i femrave	0	0	0	0	0	1	5	6	3

Numri i nxënësve në shkollën 9- vjeçare Çarshovë viti 2024-2025

Klasa	I	II	III	IV	V	VI
Nr. i nxënësve	0	0	0	0	0	1
Nr. i femrave	0	0	0	0	0	0

Numri i nxënësve në shkollën fillore Draçovë viti 2024-2025

Klasa	I	II	III	IV	V
Nr. i nxënësve	0	1	1	0	0
Nr. i femrave	0	1	0	0	0

Numri i nxënësve në shkollën fillore Kaludh viti 2024-2025

Klasa	I	II	III	IV	V
Nr. i nxënësve	0	0	3	0	1
Nr. i femrave	0	0	1	0	1



Numri i klasave paralele për shkollën 9- vjeçare “1-Maji” dhe shkollat vartëse viti shkollor 2024-2025

Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Numri i paraleleve	2	3	4	4	3	4	2	3	3

Burimi:ZAV Përmet-Këlcyrë



C. Të dhënat dhe aspekti social për Arsimin e Mesëm të Lartë

Nr	Treguesit	Të dhëna
1	-Numri i nxënësve në shkollën “S.Frashëri”	184 nx f (91)
2	-Numri i nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike	12 nx f (3)
3	-Numri i nxënësve pa njërin prind	10 nx f (4)
4	-Numri i nxënësve që nuk janë në kujdestarinë e prindërve	0 nx
5	-Numri i nxënësve të komunitetit romë/egjiptianë	7 nx f (4)
6	-Numri i nxënësve që vinë nga familje me prindër të divorcuar	9 nx f (5)
7	-Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara	3 nx f (1)
